

## KËRKESË

**OBJEKTI:** Kërkesë për mundësimin e transmetimit *live* për publikun të seancave

**DREJTUAR:** **Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**  
Gjyqtarëve  
Znj. Elsa Ulliri, znj. Flora Hajredinaj dhe z. Besmir Stroka

**PËR DIJENI:** **Top Channel**  
*Rruga "17 Nëntori", Nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar, Tiranë.*

**Tv Klan**  
*Rruga "Aleksandër Moisiu", nr.97, Pranë Ish-Kinostudio, 1007, Tiranë.*

**Vizion Plus TV**  
*Rruga Don Bosco, Nr.5, Tiranë.*

**Report TV**  
*Rrugën "Ndre Mjeda" 10, Tiranë.*

**Euronews Albania**  
*Rruga: Rezervat e Shtetit, Lundër 1, Tiranë 1001.*

**A2 CNN**  
*"ABA Business Center", RR, Rruga Papa Gjon Pali II, Tiranë 1001.*

**News 24**  
*"Ish uzina autotraktorve" Shkoze. Rruga "Ali Demi", 1001 Tiranë.*

**MCN TV**  
*"Rruga e Vilave", Lundër*

**KËRKUES:** **Erion VELIAJ**, i biri i Luan dhe i Shqiponjë, i datëlindjes 17.12.1979, lindur e banues në Tiranë.  
Përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga Av. Plarent Ndreca.

**BAZA** Neni 339 dhe 340 i Kodit të Procedurës Penale  
**LIGJORE:**

*Të nderuar Gjyqtar,*

1. Nëpërmjet kësaj kërkesë, ju drejtohem për të kërkuar që një parim themelor i të drejtës për proces të rregullt, publiciteti i seancës, të realizohet në mënyrë të plotë dhe efektive në gjykimin e procedimit penal nr.27/2024. Në bazë të nenit 339 të KPrP, ky gjykim zhvillohet me dyer të hapura. Pikërisht sepse në KPrP, transparenca është konsideruar në interes jo vetëm

të palëve, por edhe të publikut dhe vetë sistemit të drejtësisë. Pikërisht për këtë arsye, kërkesa që paraqes sot lidhet me mënyrën konkrete se si ky parim duhet të realizohet në praktikë. Më konkretisht, kërkoj nga Gjykata që të lejojë praninë e një kamere të mediave për transmetimin e drejtpërdrejtë të çdo seance, ose, në alternativë, që vetë Gjykata të mundësojë transmetimin *live* të çdo seance, përmes një sinjali institucional të kontrolluar prej saj, në mënyrë që publiku të ketë akses të drejtpërdrejtë në zhvillimin e procesit.

2. Aktualisht, edhe pse seanca është e hapur, mundësia reale e publikut për ta ndjekur atë mbetet e kufizuar në mënyrë të ndjeshme. Prania fizike e një numri të kufizuar personash në sallë dhe e disa përfaqësuesve të mediave nuk mund të zëvendësojë aksesin e drejtpërdrejtë të qytetarëve në një proces që, sipas ligjit, është publik. Në këto kushte, publiciteti rrezikon të mbetet më shumë formal sesa real. Për më tepër që ky proces nuk ka vetëm një dimension individual, por edhe një dimension të qartë publik, si Kryetar i Bashkisë së Tiranës, unë ushtroj një funksion të zgjedhur dhe mbaj përgjegjësi direkte përpara qytetarëve, ndërsa akuzat e ngritura lidhen me ushtrimin e këtij funksioni dhe me pretendime për korrupsion.

3. Në këto kushte, interesi i publikut për të ndjekur drejtpërdrejt zhvillimin e gjykimit është objektivisht më i lartë dhe më i intensifikuar. Kjo nuk krijon asnjë të drejtë shtesë për mua si i pandehur, por rrit nivelin e kërkuar të transparencës që duhet të garantohet nga vetë Gjykata. Në një situatë të tillë, kufizimi i aksesit të publikut vetëm në një prani fizike të kufizuar për shkak të vendeve të kufizuara në sallë, pa mundësinë e ndjekjes së drejtpërdrejtë të seancës; pranisë së kufizuar të medias, pa kamera, rrezikon të dobësojë funksionin e publicitetit si instrument kontrolli publik dhe të cenojë perceptimin e besimit në drejtësi. Për rrjedhojë, lejimi i transmetimit *live* përbën një mjet të domosdoshëm për të përmbushur në mënyrë reale standardin e transparencës që kërkohet në një çështje me këtë natyrë dhe rëndësi.

4. Në këtë fazë të procesit, çështja lidhet me vetë thelbin e garancive procedurale që strukturojnë një gjykim penal të drejtë. Në një kontekst ku gjykimi ka një interes të shtuar publik për shkak të funksionit që ushtroj si Kryetar i Bashkisë së Tiranës dhe natyrës së akuzave të ngritura, që lidhen me ushtrimin e këtij funksioni, ajo që vihet në diskutim është nëse parimi i publicitetit, i sanksionuar në mënyrë kategorike në nenin 339 të Kodit të Procedurës Penale, realizohet në mënyrë efektive, apo mbetet në nivel formal, duke u zbrazur nga përmbajtja e tij reale.

5. Në të njëjtën linjë, duhet theksuar se vetë sistemi ynë juridik e njeh dhe e aplikon tashmë në praktikë transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave gjyqësore, kur ato zhvillohen në mënyrë publike. Në veçanti, në Gjykatën Kushtetuese, seancat që nuk zhvillohen me dyer të mbyllura transmetohen *live* për publikun, pikërisht për të garantuar transparencë të plotë dhe

akses real të qytetarëve në procesin gjyqësor. Kjo praktikë tregon qartë se transmetimi i drejtpërdrejtë nuk konsiderohet i papajtueshëm me solemnitetin, qetësinë apo zhvillimin normal të gjykimit, përkundrazi, ai shihet si një instrument legjitim për realizimin efektiv të parimit të publicitetit. Në rastin konkret, për shkak të interesit të lartë publik për këtë çështje e për më tepër kur vetë unë, subjekt që prekem nga ky proces, që kërkoj transmetimin e tij publik, aplikimi i një standardi më restriktiv se ai që zbatohet në gjykimin kushtetues mbetet i pajustificuar dhe cenon koherencën e vetë sistemit të drejtësisë në raport me transparencën e procedurave gjyqësore.

6. Gjithashtu theksojmë se Gjykata nuk mund ta refuzojë këtë kërkesë duke u mbështetur mekanikisht në nenin 14 të vendimit nr. 716, datë 06.12.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për miratimin e Udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”. Ky akt nuk mund të lexohet si burim i një ndalimi të përgjithshëm të kamerave në seancat gjyqësore publike. Ai mund të rregullojë vetëm mënyrën teknike të marrëdhënies së gjykatave me median, por nuk mund të krijojë kufizime të reja mbi publicitetin e gjykimit, lirinë e informimit dhe aksesin real të publikut në seancë, përtej atyre që parashikohen shprehimisht nga Kushtetuta dhe ligji procedural penal.

7. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet vetëm me ligj, vetëm për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, dhe vetëm në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë kufizim. Për rrjedhojë, një udhëzues administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të shërbejë si bazë autonome për të ndaluar filmimin ose transmetimin e një seance që, sipas nenit 339 të Kodit të Procedurës Penale, zhvillohet publikisht. Publiciteti i seancës nuk është një “tolerim administrativ” i gjykatës ndaj publikut ose medias; ai është garanci ligjore e procesit penal dhe instrument kontrolli publik mbi mënyrën se si ushtrohet pushteti gjyqësor.

8. Në këtë kuptim, çdo interpretim i nenit 14 të vendimit nr. 716/2023 që e kthen ndalimin e kamerave në rregull dhe lejimin e tyre në përjashtim, është i papajtueshëm me nenin 339 të Kodit të Procedurës Penale. Ky nen e vendos publicitetin si rregull të shqyrtimit gjyqësor penal, ndërsa neni 340 i të njëjtit Kod përcakton rastet kur gjykata mund të kufizojë publicitetin, duke urdhëruar zhvillimin e seancës ose të disa veprimeve me dyer të mbyllura. Këto raste lidhen me interesa konkrete dhe të individualizuara, si mbrojtja e moralit, rendit të seancës, sekretit shtetëror, sigurisë së dëshmitarëve ose të pandehurve, mbrojtja e të miturve, viktimave të posaçme apo interesa të tjera të përcaktuara nga ligji. Jashtë këtyre rasteve, gjykata nuk mund të krijojë një kufizim shtesë duke u mbështetur vetëm në një akt nënligjor.

9. Për më tepër, edhe vetë neni 14 i vendimit nr. 716/2023, nëse lexohet në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale, nuk e autorizon gjykatën të refuzojë në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte praninë e kamerave. Ai mund të shërbejë vetëm si bazë për administrimin teknik të tyre, por ai nuk mund të përdoret si bazë për ndalim të plotë, në mungesë të një rreziku konkret, real dhe të provuar për procesin. Prandaj, testi që duhet të zbatohet Gjykata në këtë rast nuk është nëse kamerat janë “të dëshirueshme” ose “jo të dëshirueshme” nga palët në proces, por nëse ekziston një arsye ligjore konkrete që e bën të domosdoshëm kufizimin e tyre. Nëse një palë, dëshmitar, subjekt procedural ose organ publik kundërshton filmimin, ky kundërshtim nuk mund të ketë efekt vetoje mbi publicitetin e seancës. Gjykata duhet të verifikojë konkretisht: cili interes i mbrojtur me ligj cenohet; në çfarë mënyre cenohet; sa real është rreziku; nëse rreziku mund të shmanget me masa më pak kufizuese; dhe pse ndalimi i plotë i kamerave do të ishte masa e vetme e nevojshme dhe proporcionale. Pa këtë analizë konkrete, refuzimi i kamerave do të ishte një kufizim formal, abstrakt dhe jo proporcional i publicitetit të gjykimit.

10. Në rastin konkret, kërkesa nuk synon cenimin e rendit të seancës, të procesit të rregullt ligjor, të privatësisë së palëve, të të dhënave personale, të sigurisë së dëshmitarëve apo të mbrojtjes së të miturve. Përkundrazi, kërkesa synon që këto interesa të mbrohen, nëse dhe kur lind nevoja, përmes masave konkrete, të individualizuara dhe proporcionale, pa u kthyer në bazë për ndalimin e përgjithshëm të transmetimit të një procesi që është publik sipas ligjit. Nëse gjatë gjykimit paraqitet një akt, dëshmi, e dhënë personale ose situatë konkrete që kërkon mbrojtje, Gjykata mund të vendosë kufizim të pjesshëm, ndërprerje të përkohshme të transmetimit, mosfilmim të një personi të caktuar, përdorim të pamjeve të kontrolluara, transmetim me vonesë ose çdo masë tjetër më pak kufizuese. Por nuk mund të refuzohet që në fillim transmetimi i të gjithë procesit, pa identifikuar një rrezik konkret.

11. Publiciteti i seancës nuk matet vetëm me faktin formal që dera e sallës së gjykimit është e hapur. Në një çështje me interes të lartë publik, ku kapaciteti fizik i sallës është i kufizuar dhe ku objekti i gjykimit lidhet me ushtrimin e një funksioni të zgjedhur publik, prania e pak personave në sallë nuk garanton akses real të publikut. Në këto kushte, media dhe transmetimi i drejtpërdrejtë janë mjeti përmes të cilit publiciteti bëhet efektiv. Pa këtë akses, gjykimi mbetet formalisht publik, por realisht i paarritshëm për shumicën e publikut. Për rrjedhojë, Gjykata duhet ta interpretojë çdo rregull nënligjor në pajtim me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale. Rregulli është lejimi i filmimit dhe transmetimit të seancës publike, ndërsa kufizimi duhet të jetë përjashtim, i mbështetur në ligj, i arsyetuar konkretisht dhe proporcional. Çdo zgjidhje tjetër do ta zhvendoste publicitetin e gjykimit nga garanci ligjore

në çështje diskrecioni administrativ, gjë që nuk pajtohet me natyrën e një procesi penal publik dhe me standardin kushtetues të procesit të rregullt ligjor.

12. Në këto kushte, lejimi i transmetimit të drejtpërdrejtë nuk është çështje zgjedhjeje, por detyrim për Gjykatën, për të siguruar që publiciteti i gjykimit të mos mbetet formal, por të realizohet plotësisht në përputhje me standardin ligjor dhe me interesin publik që kjo çështje përfaqëson.

Në pritje të vendimmarrjes tuaj lidhur me këtë kërkesë.

*Me respekt,*

**ERION VELIAJ**

Përfaqësuar nga

**Av. Plarent NDRECA**